



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA
01 Nr.No. 052-15372/19
Data-Data-Datum 08.05.2023
Klinë-Klina

**RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK PËR DRAFT-RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA DHE
NGARKESA KOMUNALE**

Prill, 2024

HYRJE

Draft-Rregullorja për Taksa, Tarifa Dhe Ngarkesa Komunale, është një prej dokumenteve të rëndësishme të Komunës së Klinës, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë.

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Klinës (këtu e tutje “Komuna”), lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruara nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT-RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

Kryetari i Komunës së Klinës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Yhvillimit (Iniciuesi apo propozuesi i aktit), si dhe Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, duke respektuar UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË, më vendim më numër protokoll 01 Nr. 112-14101/2024, të datës 24.04.2024, kanë caktuar grupin punues në përbërje prej tre personave:

1. Burim Hoti, kryesues,
2. Mirsad Dakaj anëtarë
3. Adnan Zeneli, anëtarë.

Grupi punuese si dhe Zyrtari Përgjegjës për Konsultim Publik kanë hartuar planin e brendshëm të organizmit të konsultimit, agjendën, identifikimin e palëve, identifikimin e mjeteve të komunikimit, identifikimin e burimeve, mjeteve, formave dhe mënyrave të nevojshme për procesin e konsultimit publik si dhe përmbylljen e procesit me shqyrtimin e kërkesave.

Përveç takimit të drejtpërdrejtë me publikun në ambientin e Sallës së Kuvendit Komunal Klinë, grupi punues ka shfrytëzuar metodën për konsultim me qytetarët prej 30 ditësh në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe në platformën e konsultimit publik në nivel të qeverisë së Republikës së Kosovës:

Komuna Klinë:

<https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/>

Platforma e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Materiali për konsultim publik iu është mundësuar të gjithë të interesuarve të merret në formë fizike në **Zyrën e drejtorisë së Financave**. Po ashtu, ka qenë i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të **Komunës së Klinës** si dhe në **Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike**.

Komuna e Klinës e ka të paraparë organizimin e këtij konsultimi publik edhe më **PLANIFIKIMIN E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2024**:

Nr.	Emri i konsultës	Koha e mbajtjes së konsultës
1.	DRAFT-RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE	MARS – Prill 2024

Shtojca nr. 1 – Tabela e detajuar me numrin e takimeve, pjesëmarrësve dhe numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Takimi i drejtpërdrejtë	29.04.2024	27 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë

			parashtruar komente
Platformat elektronike	17.04.2023 03.05.2024	2 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës ka dhënë 3 sugjerime-kërkesë nëpërmjet emailit

Dokumentet e lartcekura i janë nënshtruar konsultimit publik në ueb-faqen e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

The screenshot shows the header of the RKS website. On the left is the logo of the Republic of Kosovo. The main header text reads: "REPUBLIKA E KOSOVËS QEVERIA - ZYRA E KRYEMINISTRIT ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË". To the right, there are language options: "Shqip | English | Srpski" and a search bar labeled "Kërko...". Below the header is a dark navigation bar with the following items: "Ballina", "Lajmet", "Rreth platformës", "Institucionet", "Kërko konsulta", "Takimet konsultative", "Dokumentet", "Statistika", "Kontaktet", and "Kycu". Below the navigation bar, the text "Konsultimet publike" is visible on the left and "07.05.2024" on the right.

Komuna Klinë/Lista e konsultimeve publike

Të hapura Të mbyllura

Emri konsultes	Data e fillimit	Data e përfundimit	Shiko
Njoftim për Konsultim Publik për Draft-Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale	17.04.2024	03.05.2024	Shiko

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 2 të këtij raporti.

Shtojca nr. 2 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara:

Temat e Konsultimit	Numri i kërkesave / Sugjerimet / Komentet	Numri i personave që kanë dhënë komente,	Statusi i kërkesës / sugjerimi (të pranuar, pjesërisht e	Statusi i kërkesës / sugjerimi që
---------------------	---	--	---	-----------------------------------

		kërkesa / sugjerime	pranuar apo nuk është pranuar)	nuk është pranuar
DRAFT-RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE	Takimi i drejtpërdrejtë 2 Komente	2 pjesëmarrës kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	2 komente të pranuar	0 komente të refuzuar
DRAFT-RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE	Platformat elektronike 20 kërkesa	3 pjesëmarrës kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	20 kërkesa të pranuar	00 kërkesa të refuzuara
Gjithsej	22 kërkesa	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	22 kërkesa të pranuar, 0 pjesërisht të pranuar	0 kërkesa të refuzuara

Shtojca nr. 3 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara:

Temat e konsultimit Publik	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
DRAFT-RREGULLORE PËR TAKSA,	Kërkesë: Si drejtori përgjegjës për stacionin e autobusëve ne	Qendrim Millaku, Klinë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës

<p>TARIFA DHE NGARKESA KOMUNAE</p>	<p>Klinë, propozojmë qe te ndryshohet tarifat e nisjeve nga stacioni i autobusëve, në bazë te caktimit të tarifave për nisjet e transportit rrugore nga stacioni i autobusëve.</p> <p>1. Çdo nisje nga stacioni i autobusëve, operatoret e transportit publik te udhëtareve me autobus do te paguajnë për peron;</p> <p>2. Për linjat urbanë- periferike me vlere = 1.50€ -Çdo nisje nga stacioni i autobusëve, operatoret e transportit publik te udhëtareve me kombi-taksi do te paguajnë për peron;</p> <p>3. Për linjat urbanë- periferike me vlere = 1.00€</p>	<p>Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente</p>		<p>së Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente ka pranuar që të vendosen tarifat në stacionin e autobusëve.</p>
<p>DRAFT- RREGULLO RE PËR TAKSA, TARIFA</p>	<p>Kërkesë: Ndryshimin e çmimit të certifikatës së regjistrimit të fermerit që është pa</p>	<p>Rexhep Rexhepi, Klinë. Zyrtar në Drejtorinë e</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit ka pranuar kërkesën me arsyetimin që për</p>

DHE NGARKESA KOMUNAE	pagesë, e që në të kaluarën ka qenë 3 euro.	Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.		nxjerrjen e këtij dokumenti duhet të bëhet pagesë 2€.
DRAFT- RREGULLO RE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNAE	Koment: Tarifat dhe pagesat të cilat bëhen brenda QKMF-së, propozimet: 1. Ekzaminimi mjekësor i mjekut të përgjithshëm në punkt, QMF ose në QKMF pa analiza laboratorike dhe pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë 1.00 €, 2. Ekzaminimi specialistik në QKM/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes 2.00 €, 3. Ekzaminimi specialistik në QKMF/QMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes 5.00 €, 3. Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente 6.00 €, 4. Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike 0.30 €, 5. Ultrazëri standard 2.00 €, 6. Radiografia	Gazmend Bojaj, drejtor i QKMF-së “Nënë Tereza” në Klinë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesave nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF “Nënë Tereza”, ka pranuar kërkesat

	<p>2.00 €</p> <p>7. EKG 0.50 €</p> <p>8. Analizat laboratorike-hemogrami dhe urina 1.00 €</p> <p>9. Analizat laboratorike (komplet) 3.00 €,</p> <p>10. Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve 1.00 €,</p> <p>11. Audiograma 1.00 €,</p> <p>12. Shpëlarja e veshit 1.00 €,</p> <p>13. Dhënia e injeksionit intramuskulor në shtëpi, përpos në rastet emergjente 1.00 €,</p> <p>14. Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente 1.00 €,</p> <p>15. Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë) 3.00 €,</p> <p>16. Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor 1.00 €,</p>			
--	--	--	--	--

	<p>17. Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve 18.00 €,</p> <p>18. Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore për punësim 18.00 €,</p> <p>19. Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore 18.00 €,</p> <p>20. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore 5.00 €,</p> <p>21. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive – për një orë 25.00€.</p>			
<p>DRAFT-RREGULLO RE PËR TAKSA, TARIFA DHE</p>	<p>Propozim: 1. Neni 37, paragrafi 7, propozohet që të plotësohet në mënyrë që të nënkuptojë se nga</p>	<p>Edmond Vllasaliu, IPKO Telecommunications LLC.</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Përgjigja:</p> <p>Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesave nga Edmond Vllasaliu,</p>

<p>NGARKESA KOMUNAE</p>	<p>ky obligim përjashtohen kompanitë e telekomunikimit në ndërtimet të cilat kanë për qëllim instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të telekomunikimit. 2. Neni 44, paragrafi 16.7, propozojmë që kjo dispozitë të largohet në tërësi nga rregullorja apo në mënyrë specifike të përcaktohet se operatorët e shpërndarjes, lirohen nga ky obligim si ofrues të shërbimeve.</p>			<p>IPKO Telecommunications LLC ka pranuar kërkesat.</p>
<p>DRAFT- RREGULLO RE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNAE</p>	<p>Kërkesë: Është bashkangjitur më poshtë për shkak të renditjes dhe numrit të madh të komenteve.</p>	<p>Enver Mala, zyrtar në komunën e Klinës</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesave nga Enver Mala, zyrtar në komunën e Klinës ka pranuar kërkesat.</p>

Enver Mala, zyrtar në komunën e Klinës:

Neni 13

Ankesat dhe mbrojtja juridike

1. Pala mund të ushtrojë ankesë ndaj vendimeve të lëshuara nga organet komunale kompetente, lidhur me tarifatat dhe ngarkesat komunale sipas kësaj rregulloreje, krejt këtë në afatin e paraparë ligjor dhe në pajtim ~~me Statutin e Komunës~~. **me dispozitat e Ligjit të veçantë dhe Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.** (statuti nuk përcakton afat kohor për parashtrimin e ankesës, por vetëm e një të drejtën e ankesës)

2 . Procedura e ankesës duhet të jetë në përputhje me dispozitën e nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe dispozitat përkatëse të Ligjit ~~për Procedurën Administrative nr. 02/L-28~~. Të zëvendësohet me termin : **“për Procedurën e Përgjithshme Administrative”** (Ligji për Procedurën Administrative Nr.02/L-028, nga qershori i vitit 2017 është shfuqizuar, pra, nuk prodhon pasoja juridike)

Komentet lidhur me Draftin e projekt Rregullores për Taksat, Tarifatat dhe Ngarkesat Komunal

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që ndodhet brenda **territorit** të (**te shtohet**) Komunës, paguan taksë vjetore komunale në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste profesionale, për aktivitet ekonomike të zhvilluar si në vijim:

1. kategoria A:

	Kategoria A	
2.3.	htëpitë Shtëpitë	400 €

Neni 22

Të hyrat tjera vetanake komunale

Të hyrat tjera vetanake të autorizuar në bazë të kësaj Rregulloreje nuk janë gjithëpërfshirëse. Komuna mund të ~~vjelë dhe~~ Propozohet te largohet, dhe te riformulohet si ne vijim:
“Të hyrat tjera vetanake të autorizuar në bazë të kësaj Rregulloreje nuk janë gjithëpërfshirëse. Komuna mund të mbledhë edhe të hyra të tjera përmes tarifave dhe taksave përkatëse komunale, të cilat mund të lejohen me ndonjë ligj tjetër apo edhe në bazë të marrëveshjes me autoritetet qendrore.”

Neni 24

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik i cili është banor i Komunës dhe ~~pronëson~~ (të zëvendësohet) **ka në pronësi** mjet motorik dhe çdo person juridik që ka seli në Komunë dhe ka në pronësi mjet motorik, paguan taksën vjetore mbi pronësinë e mjetit motorik, si në vijim:

Neni 54

Taksat Qendrore

1. ~~Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komuna ofron shërbime të ndryshme të deleguar nga niveli qendror dhe mbledh taksë të përeaktuar nga ky nivel.~~

Propozohet ky paragraf të riformulohet si në vijim : “Me qëllim të zbatimit të Ligjeve pozitive të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, komuna ofron shërbime të ndryshme të deleguar nga niveli qendror dhe mbledh taksa të përcaktuara nga ky nivel”, si në vijim:

1.1. Taksa për ofrimin e shërbimeve kadastrale të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.12/2019 për Ndarjen dhe Regjistrimin e parcelës apo çdo legjislacioni pasues;

1.2. Taksa për ofrimin e shërbimeve kadastrale të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 08/ 2014 për Tarifatat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyrrat Kadastrale Komunale;

1.3. Taksa për dhënien e lejes mjedisore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Komunale Mjedisore apo çdo legjislacioni pasues; **(ky shërbim nuk është kompetencë e deleguar, shih nenin 18 të Ligjit për vetëqeverisje lokale)**

1.4. Taksa për shërbimet shëndetësore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 – Mbledhja dhe Shfrytëzimi i Mjeteve nga Bashkëpagesat e Shfrytëzuesve të Shërbimeve Shëndetësore dhe të Hyrave Vetanake të Institucioneve Shëndetësore apo çdo legjislacioni pasues; **(ky shërbim nuk është kompetencë e deleguar, shih nenin 18 të Ligjit për vetëqeverisje lokale)**

1.5. Taksa për qasje në dokumente publike të përcaktuara sipas Rregullores Nr. 02/2012/MF për Tarifatat në Qasje në Dokumente Publike apo çdo legjislacioni pasues; **(ky shërbim nuk është kompetencë e deleguar, shih nenin 18 të Ligjit për vetëqeverisje lokale)**

1.6. Taksa për vijim dhe përfundim të arsimit dhe aftësimit për të rritur të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2011 për Partecipim të Vijuesve të Arsimit dhe Aftësimit për të Rritur apo çdo legjislacion pasues; **(ky shërbim nuk është kompetencë e deleguar, shih nenin 18 të Ligjit për vetëqeverisje lokale)**

1.7. Taksa për shërbimet e ofruara për regjistrim të bizneseve, të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 11/2018 për Përcaktimin e Taksave për Shërbimet e Ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve apo çdo legjislacion pasues;

1.8. Taksa për lëshimin e dokumentacionit arsimor dublikatë, të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ 03/2013 – Lëshimi i Dokumenteve Dublikatë nga Institucionet Edukativo – Arsimore dhe Universitare apo çdo legjislacion pasues; **(ky shërbim nuk është kompetencë e deleguar, shih nenin 18 të Ligjit për vetëqeverisje lokale)** dhe

1.9 Taksa për shfrytëzimin e kullosave të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ MA-NR për Shfrytëzimin e Kullosave. **(ky shërbim nuk është kompetencë e deleguar, shih nenin 18 të Ligjit për vetëqeverisje lokale)**

2. Çdo akt normativ tjetër i Qeverisë së Republikës së Kosovës **apo ndonjë agjencie të pavarur (te largohet sepse agjencia nuk ka drejtë me nxjerr akte nënligjore. Është pjesë përbërëse e ministrisë së caktuar)** që miratohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje që parasheh taksa qendrore, zbatohet nga Komuna, pa pasur nevojë që kjo Rregullore të ndryshojë.

Procesit të organizimit të konsultimeve publike për DRAFT-RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNAE, i kanë kontribuar me pjesëmarrje **27** persona, një operator privat si dhe një drejtori komunale.

Shtojca Nr. 3 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë:

Femra	5
Meshkuj	22
Total:	27

Kryesuesi i Grupit Punues,

Burim Hoti



Klinë, 07.05.2024